



**Më shumë
Zgjedhje** përmes
Politikave Miqësore për Familjen



Financuar nga
 Austrian
Development
Cooperation

ANALIZË E POLITIKAVE TË PËRGJEGJSHME GJINORE PËR FAMILJEN NË SHQIPËRI

REKOMANDIMET


Forcimi i të dhënave administrative

Të dhënat administrative sigurojnë një informacion periodik me kosto të ulët. Nga ana tjetër anketat janë të kushtueshme dhe japin informacion në një moment kohor specifik. Për këtë arsye, fuqizimi i sistemit të mbledhjes së të dhënave administrative do të krijonte mundësinë e një analize më të mirë dhe matjes së ndikimit të politikave miqësorë të familjes në vend. Për më tepër, i gjithë sistemi i mbledhjes së të dhënave administrative duhet të sigurojë një ndarje sipas gjinisë. Gjithashtu, të dhënat duhet të jenë të ndara sipas vendbanimit, moshës, arsimit, statusit të punësimit, aftësisë së kufizuar, etnicitetit etj.



Qendërzimi dhe standardizimi i mbledhjes së të dhënave për çerdhet

Aktualisht, ky informacion mblidhet më vete nga secila prej 61 bashkive. Ky lloj decentralizimi i mbledhjes së të dhënave nuk lejon një standardizim dhe e bën të vështirë aksesin e të dhënave në kohë reale për analizë. Një institucion i vetëm duhet të marrë përgjegjësinë për t'i mbledhur këto të dhëna, duke respektuar një metodologji standarde.



Kryerja e një ankete të re të Përdorimit të Kohës në Shqipëri

Anketa e fundit e përdorimit të kohës në Shqipëri u krye në vitin 2010, gjë që e bën analizën e përdorimit të kohës për aktivitete të paguara dhe papaguara relativisht të vjetër dhe jo të azhurnuar. Anketa të tilla, nuk kryhen më shpesh se pesë ose dhjetë vjet, pasi mënyra se si përdoret koha nuk pritet të ndryshojë shumë me kalimin e kohës. Megjithatë, duke marrë në konsideratë kushtet e reja, si pandemia COVID-19 puna nëpërmjet internetit, gjithashtu dhe ndryshimet ligjore që mund të ndodhin nën kontekstin e politikave miqësore familjare, zbatimi i një ankete të tillë mund të përsëritet çdo 4-5 vite.



Fuqizimi i disagregimit i të dhënave për kopshtet

Aktualisht, afërsisht tetë në dhjetë fëmijë të moshës 3-6 vjeç janë të regjistruar në kopshte. Sidoqoftë, analiza e kësaj fushe mbetet sipërfaqësore duke qenë se nuk ka të dhëna për vendbanimin e prindërve, statusin e punësimit të tyre, nivelit e tyre arsimor si dhe nivelin e kënaqësisë që ato kanë me të tilla institucione. Për këtë arsye, analiza nuk jep një panoramë rreth sfidave dhe vështirësive të mundshme që prindërit mund të kenë për aksesin e këtyre institucioneve për fëmijët e tyre.



Kryerja e anketave të dedikuara tek individët si dhe/ose tek ndërmarrjet për të matur dhe kuptuar nevojat dhe vështirësitë e tyre në drejtim të ekuilibrit të jetës midis familjes dhe punës

Për të thelluar kuptimin brenda kontekstit të vendit në funksion të zbatimit të suksesshëm të politikave miqësorë për familjen, duhet të kryhen studime sasiore dhe cilësore specifike tek individët dhe tek ndërmarrjet private. Kjo do të mundësonte kuptimin e nevojave dhe sfidave të këtyre aktorëve, duke lejuar zbatimin e politikave të tilla në drejtimin e duhur dhe duke targetuar nevojat specifike në kontekstin e vendit.

